

Në bazë të nenit 40 të Statutit të Komunës së Prishtinës, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave të Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur me dat. 31.01.2002, miratoi këtë:

R R E G U L L O R E

PËR KRYERJEN E TRANSPORTIT ME AUTOMJETET “AUTO TAXI”

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1

Me këtë vendim caktohet kryerja e veprimtarisë “Atuo-taxi” për bartjen e udhëtarëve me atuo mjete në teritorin e qytetit të Prishtinës.

Neni 2

Transporti i udhëtarëve është veprimtari të cilën e kryen ngasësi me taksi automjetin për të cilin relacioni dhe kushtet tjera caktohen për secilën bartje në veqanti.

Neni 3

Bartjen e udhëtarëve me taksi automjete mundë t’ a kryejn personat fizik që këtë e kanë profesion të vetëm dhe ndërmarrjet të cilat i plotësojnë kushtet e caktuara me ligj dhe me këtë Rregullore.

II. KUSHTET PËR KRYERJEN E TRANSPORTIT ME “AUTO-TAXI”

A. Personi fizik

Neni 4

Përpos kushteve të parapara me Ligjin mbi kryerjen e transportit me “Auto-taxi” personi fizik duhet t’i përmbush këto kushte:

1. Të ket lejen e ngasësit të kategorisë “B”,
2. Të jetë pronar i automjetit me të cilin kryen këtë veprimtari,
3. Të ket vendbanimin në teritorin e Komunës së Prishtinës,
4. Të ket së paku dy vite përvojë pune si ngasës i automjetit,
5. Që të mos i jetë shqiptuar masa mbrojtëse e ndalimit të kryerjes së transportit me “Auto-taxi” më gjatë se gjashtë (6) muaj.

Dispozitat nga paragrafi 1 pika 5 e kësaj Rregullore nuk do të aplikohen nëse kanë kaluar 5 vite nga dita e skadimit të ndalesës.

Personi fizik mundë të kryej këtë veprimtari vetëm me automjetin e vet personal të cilin vetë personi e nganë ose personi të cilin ai e autorizon dhe i cili është i regjistruar në lejen e dhënë për “Auto taxi”.

B. Ndërmarrja

Neni 5

Për kryerjen e transportit “Auto-taxi” ndërmarrja duhet t`i plotësoj këto kushte:

1. Që të jetë i regjistruar për këtë lloj të transportit,
2. Që ngasësit e taksive në ndërmarrje të plotësojnë kushtet e parapara me nenin 4 të kësaj Rregullore.
3. Të jetë pronar i automjeteve të cilat i plotësojn kushtet e parapara me kësaj Rregullore,
4. Të ket selinë në teritorin e Komunës së Prishtinës.

III. PUNËT ADMINISTRATIVE

- A. Aktvendimin mbi kryerjen e transportit “Auto- taxi” e lëshon organi administrativ i Komunës sipas pelqimit të dhënë nga Drejtorati i Shërbimeve Publike Transport dhe Ambient (DSHPTA).

Neni 6

Punët administrative në lëminë e transportit “Auto- taxi” i kryen organi administrativ i Komunës me pelqimin e DSHPTA.

Neni 7

Kërkesa për kryerjen e transportit “Auto- taxi” i bëhet organit administrativ të Komunës.

Kërkesës i bashkangjitet edhe dëshmia mbi plotsimin e kushteve të parapara me ligj dhe këtë Rregullore.

Neni 8

Aktvendimin mbi regjistrimin në regjistër për kryerjen e transportit “Auto- taxi” e bie organi administrativ i Komunës.

Pas aktvendimit nga paragrafi paraprak, ngasësit të automjetit “Auto- taxi” i lëshohet edhe leja e “Auto- taxit” e cila vlen një (1) vit.

Ngasësi i “Auto taxit” obligohet që organit të administratës, tetë(8) ditë para skadimit të lejës të bëjë kërkesë për vazhdimin e së njëjtes.

Poashtu ngasësi i auto taksit është i obliguar që t'i paraqes organit administrativ të Komunës të gjitha të dhënat respektivisht ndryshimet të cilat i përmban leja e auto taksit (ndërrimi i automjetit, adresës etj) në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e paraqitjes së këtij ndryshimi.

Ndërmarrja është e obliguar që të gjitha ndryshimet lidhur me të dhënat që i përmban aktvendimi mbi kryerjen e transportit auto taksi si dhe leja auto taksi ti paraqes organit administrativ të Komunës në afat prej (8) tetë ditësh nga dita kur janë paraqitur ndryshimet.

Formën dhe përmbajtjen e lejes auto taksi e vendosë Drejtorati i Shërbimeve Publike, Transport dhe Mbrojtje të Ambientit i cili do ta definoj me aktvendim të posaçëm.

B. Ndërprerja e përkohëshme e kryerjes së transportit auto taxi

Neni 9.

Ngasësi mundet përkohësisht të ndërprej kryerjen e transportit auto taksi në kohën e:

1. Pushimit mjeksorë ose atij të lindjes,
2. Aftësimi profesional ose kryerjës së funksionit publik,
3. Shfrytëzimi i pushimit vjetor në kohëzgjatje prej 18 ditësh (pune) gjatë vitit kalendarik,
4. Riparimet e automjetit me të cilin e kryen transportin e udhëtarëve me auto taksi në kohëzgjatje prej 15 ditësh, gjatë vitit kalendarik,
5. Paraburgimit ose vuajtjes së dënimit me burg në kohëzgjatje deri në (6) gjastë muaj si dhe për kohën sa zgjatin masat e hetuesisë, respektivisht masës mbrojtëse të ndalimit të ngasjës së automjetit.

Neni 10

Kërkesën për ndërprerjen e përkohëshme të kryerjes së veprimtarisë nga neni 1 i kësaj Rregullore, vozitësi i automjetit auto taksi i parashtron organit administrativ të Komunës në afat prej 5 (pesë) ditësh nga dita e paraqitjes së rrethanave nga neni 9 i kësaj Rregullore.

Pas kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni ngasësi i automjetit auto taksi është i obliguar ta kthejë lejën e auto taksit menjëher.

Ngasësi i auto taksit po ashtu është i obliguar që të rifillojë me punë në afatë prej 3 ditësh nga dita e ndërprerjes së rrethanave për të cilat është lejuar ndërprerja e kryerjes së transportit me auto taksi.

NDËRPRERJA E KRYERJES SË TRANSPORTIT ME “AUTO –TAXI”

Neni 11

Ngasësi “Auto-taxi” e ndërprejë veprimtarinë:

1. Me kërkesë për ç' regjistrim për kryerjen e veprimtarisë “Auto-taxi”,
2. Me paraqitjen e rrethanave të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 4 të kësaj Rregullore.

Neni 12

Ngasësi “Auto-taxi” është i obliguar që në rast të ndërprerjes së veprimtarisë (neni 11), organit administrativ të Komunës t'i kthejë aktvendimin dhe lejën për kryerjen e kësaj veprimtarie.

Neni 13

Veprimtaria e ndërmarrjes për kryerjen e transportit “Auto-taxi” ndërpritet me fshirjen nga regjistri.

Ndërmarrja është e obliguar që në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni t'i kthejë aktvendimin dhe lejën e punës organit administrativ i cili e ka lëshuar atë.

IV. AUTOMJETI PËR KRYERJEN E TRANSPORTIT “AUTO-TAXI”

Neni 14

Automjeti i udhëtarëve për kryerjen e transportit “Auto-taxi” (në tekstin e mëtejme: automjeti “taxi”), pos kushteve të rregulluara me ligj, duhet të përmbushë edhe këto kushte:

1. Të ket më së shumti 5 ulëse duke llogaritur edhe ulsen e ngasësit të automjetit,
2. Të ket së paku 4 dyer,
3. Të ketë motorin katërtaktësh me fuqi së paku 36,8 KV,
4. Të ket taksimetri i cili duhet të jetë teknikisht i rregullt, i bazhdaruar, i vulosur (pllombuar) dhe i vendosur asisoji që shuma të cilën e regjistron të jetë e dukshme për udhëtarin,
5. Që nxemja dhe ajrosja të jenë të rregullta,
6. Të ket shenjën “TAXI”, të vendosur mbi kulm dhe natën të ndriçuar,
7. Që çmimorja e shërbimeve në fuqi të jetë e vendosur në automjet asisoji që të jetë e dukshme për udhëtarin,
8. Që automjeti të jetë i pastër dhe pa dëmtime,
9. Që reklamat, rekomandimet dhe shenjat e ndryshme (nëse i ka) të mos jenë mbi sipërfaqet e xhamave në pjesën e përparme dhe të prapme të automjetit motorik si dhe xhamat nuk guxojnë të jenë të ngjyrosur,
10. Të posedojë aparatën kundër zjarrit, të përforcuar në vend të dukshëm dhe të përshtatshëm,
11. Të posedojë librin e faturave të destinuar për taxi shërbime, me kopje,
12. Që automjeti të jetë teknikisht i rregullt për transportin e udhëtarëve,
13. Përveq kushteve të theksuara me paragrafin paraprak, automjetet “taxi” të ndërmarrjeve duhet të jenë të ngjyrosura me ngjyrë të njejtë,
14. Viti i prodhimit të automjetit, të jetë në maksimum dhjetë vite.

Shenja “TAXI” nga paragrafi 6 duhet të ketë gjatësinë 500 milimetra, kurse lartësinë 100-120 mm, gjerësinë në bazë 80-150 mm, dhe gjerësinë e kokës 40-50 mm.

Neni 15

Me automjet “taxi” nuk mund të transportohen:

1. Fëmijët deri në moshën 6 vjeçare pa përcjellës, përveq nëse prindëri apo kujdestari me marrëveshje me “taxi-ngasësin” ia ka besuar fëmiun për transport deri te vendi i përcaktimit,
2. Personat nën ndikimin e alkoholit apo drogës dhe personat e sëmurë me sëmundjet ngjitëse,
3. Personat që me veshëmbathjen e vet mund të dëmtojnë apo përlyejnë brendësinë e automjetit,
4. Kufomat,
5. Kafshët e ngordhura,
6. Materialet eksplozuese, radioaktive, helmuese, që ndizen lehtë, infektive dhe të tjerat të cilat për shkak të vetive të veta mund të jenë të rrezikshme për sigurinë dhe shëndetin e njerëzve apo mund të shkaktojnë dëmtim tjetër.

Neni 16

Pronari i automjetit i cili nuk ka leje për kryerjen e transportit “Auto-taxi” të udhëtarëve dhe të mallit apo shenjën automjetin “taxi” me shenjën e transportit linjor të udhëtarëve do të përjashtohet nga trafiku nga ana e inspektorit të trafikut rrugor përkatësisht nga punëtori i autorizuar i policisë asisoji që do t`i merret “leja e qarkullimit “ si dhe “targat e automjetit” në kohë prej 48 orësh deri në pesë ditë.

Aktvendimi për përjashtimin e automjetit “taxi” i dorëzohet ngasësit atypëraty. Pasojat dhe shpenzimet e krijuara për shkak të aplikimit të paragrafit 1 të këtij neni në tërësi i bartë pronari i automjetit-ngasësi.

Automjetet “taxi” nuk mund të bëjnë ngarkimin dhe zbarkimin e udhëtarëve dhe të mallit në vendqëndrimet e autobusve.

Kur “taxi-ngasësi” nuk kryen transportin taxi (përdorë automjetin për nevoja të veta) është i obliguar që nga kulmi i automobilit ta heqë shenjën “TAXI”.

Automobilat “taxi” që janë të regjistruar për kryerjen e transportit “taxi” në teritorin e komunave tjera mund të kryejnë transportin e udhëtarëve në teritorin e Komunës së Prishtinës, në rastet kur sjellin udhëtarë nga komunat e tjera, por që në kthim nuk guxojnë të marrin udhëtarë të rinjë, ndërkaq vetëm mund t`i kthejnë udhëtarët që i kanë sjellë, po ashtu këto automjete duhet t`i përmbushin kushtet nga neni 14 i kësaj Rregullore.

Me automjet “taxi” nuk mund të transportohet numër më i madhë i udhëtarëve nga numri i ulseve të regjistruar në automjet, as që mund të vendoset më vonë numër më i madh i ulësëve nga ato të regjistruara.

V. VENDQËNDRIMET E AUTOMJETEVE“TAXI”

Neni 17

Vendqëndrimi i taxive është sipërfaqe e trafikut, e destinuar për qëndrimin e automjeteve “taxi” gjatë punës së “taxi-ngasësve”. Vendqëndrimi taxi shenohet me shenjat e trafikut horizontal dhe vertikal.

Neni 18

Për mirëmbajtjen e vendqëndrimeve “taxi”, vendosjen dhe mirëmbajtjen e shenjave të trafikut në vendqëndrimet “taxi” kujdeset organizata të cilës i besohen këto punë.

Neni 19

Vendqëndrimet “taxi” i cakton Drejtorati i Shërbimeve Publike, Transport dhe Ambient në bashkpunim me Inspektionin e komunikacionit të Komunës me vendim të posaçëm.

Neni 20

Në vendqëndrimet “taxi” vendosen automjetet “taxi” sipas rendit të ardhjes. Ngasësi i “Auto-taxit” është i detyruar të jetë në automjetin e vetë gjatë kohës deri sa të gjendet në vendqëndrimin e “taxive”.

Ngasësi taxi nuk guxon të ofrojë shërbime të transportit personalisht apo përmes ndërmjetësuesit dhe transportin ta fillojë jashtë vendqëndrimit të taxive.

Taxi-ngasësi mund të marrë udhëtarë për transport jashtë vendqëndrimit të taxive në vendet ku nuk ndalohet parkimi dhe ndalja e automjeteve, por vetëm me kërkesën e udhëtarit.

Taxi- ngasësi nuk guxon të qëndrojë e as të marrë udhëtarë në vendqëndrimet për transportin publik të udhëtarëve (vendqëndrimet e autobusve dhe stacionet e autobusve dhe në zonën e këtyre vendqëndrimeve në largësi prej 100 metrave nga vendqëndrimi përkatësisht nga stacioni në të dy anët).

VI. TRANSPORTI ME “AUTO-TAXI”

Neni 21

Taxi-ngasësi është i obliguar të pranojë për transport “taxi” secilin udhëtarë në kufijt e ulësve që ka në dispozicion si dhe bagazhin e udhëtarit në kufijt e madhësisë dhe të fuqisë bartëse të hapsirës për bagazh, përveq të udhëtarëve dhe të gjësendeve nga neni 15 i kësaj Rregullore. “Taxi-ngasësi” është i detyruar që ndaj udhëtarëve të sillet me kujdes dhe në mënyrë korrekte.

Neni 22

“Ngasësi- taxi” është i obliguar që taxi-transportin ta fillojë:

- nga vendqëndrimi,
- sipas thirrjes telefonike ose me
- radio-lidhje.

Neni 23

Transporti taxi fillon me hyrjen e udhëtarit në automjet.

“Taxi-ngasësi” është i obliguar që me të hyrë të udhëtarit në automjet ta kyq taximetrit.

Neni 24

Taxi-ngasësi është i obliguar që transportin ta kryej nëpër rrugët që udhëtari i cakton, përkatësisht nëpër rrugën më të shkurtër deri te vendi i përcaktimit të udhëtarit.

Neni 24

Taxi-ngasësi është i obliguar që gjatë kohës së transportit “taxi” të vendosë lejën e taxit në automjet asisoji që ajo të jetë e dukshme për udhëtarin.

Taxi-ngasësi është i obliguar që gjatë taxi- transportit të jetë i rregulluar (i pastër me mustaqe dhe mjekërr të rregulluar, që veshëmbathja të jetë e pastër).

Taxi-ngasësi gjatë punës nuk mund të jetë i veshur me pantollona të shkurtëra, me shorc, me ndërresë pa mangë përkatësisht pa këmishë apo ndërresë si dhe të jetë i mbathur me këpucë ose patika apo sandale por me qorapa.

Neni 26

Kur taxi-ngasësi nuk kryen taxi transportin është i obliguar që nga kulmi i automjetit ta heq shejtnën “TAXI”

VII. KOMPENZIMI PËR KRYERJEN E TRANSPORTIT “AUTO-TAXI”

Neni 27

Kompensimi për kryerjen e taxi-transportit përcaktohet me çmimore të shërbimeve dhe paguhet në shumën që e tregon taxi-metri në vendin e përcaktimit të udhëtarit.

Në shumën e kompensimit për kryerjen e taxi-transportit është llogaritur edhe transporti i bagazhit. Me kërkesë të udhëtarit taxi-ngasësi është i obliguar të jep faturën për shërbimin e kryer.

Neni 28

Në rastin e pamundësisë së kryerjes së taxi-transportit të filluar, taxi-ngasësit i takon, si kompenzim, gjysma e shumës të cilën në momentin e ndërprerjes së taxi transportit e tregon taxi-metri.

Taxi-ngasësi është i obliguar që në rastin nga paragrafi 1 i kësaj Rregullore të sigurojë automjet tjetër për vazhdimin e transportit të udhëtarëve deri te vendi i përcaktimit të udhëtarëve.

Neni 29

Për pranimin e udhëtarëve të tjerë gjatë taxi-transportit deri te vendi i përcaktimit vendosë udhëtari i cili ka filluar shfrytëzimin e taxi transportit me pëlqimin e taxi-ngasësit.

Nëse udhëtari i cili është pranuar gjatë taxi-transportit vazhdon shfrytëzimin e taxi-transportit edhe pas vendit të përcaktimit të udhëtarit i cili ka nisë shfrytëzimin e taxi transportit, vazhdimi i vozitjes konsiderohet me fillimin e shfrytëzimit të taxi-transportit.

Neni 30

Nëse më tepër udhëtarë shfrytëzojnë njëkohësisht taxi transportin deri te i njëjti vend i përcaktimit, kompenzimin për kryerjen e taxi transportit e paguajnë udhëtarët që e shfrytëzojnë taxi-transportin.

VIII. MBIKQYRJA

Neni 31

Mbikqyrjen mbi zbatimin e dispozitave të kësaj Rregullore e bën organi komunal i Administratës për punët e trafikut – Inspekcioni i trafikut dhe Policia.

IX. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 32

Me gjobë prej 250 DM ose 125 € do të gjobitet taxi-ngasësi për kundërvajtje, nëse:

1. Nuk vepron në pajtim me dispozitat e nenit 8 paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe të nenit 10,
2. Nëse automjeti me të cilin ushtron taxi-transportin nuk përmbush kushtet e rregulluara (neni 14 paragrafi 1 pika 1-12) dhe
3. Nëse nuk ka leje për kryerjen e transportit taxi të udhëtarëve dhe të mallit apo nëse shenon taxi-automjetin me shenjën e transportit linjor (neni 16 parag.1)

Neni 33

Me gjobë prej 250 DM ose 125 € do të gjobitet taxi-voztësi për kundërvajtje, nëse:

1. Nuk vepron në harmoni me dispozitat e nenit 12 dhe 14 paragrafi 1 pika 7, nenit 20 paragrafi 4 dhe nenit 25.

Neni 34

Me gjobë prej 150 DM ose 75€ do të gjobitet për kundërvajtje taxi-ngasësi nëse:

1. Bën transportin taxi në kundërshtim me nenin 15,
2. Nuk gjendet në automjetin taxi të vet gjatë kohës derisa ai gjendet në taxi-vendqëndrimin dhe nëse nuk vendos automjetin sipas renditjes së ardhjes (neni 20 paragrafi 1 e 2),
3. Nëse personalisht apo përmes ndërmjetësuesit ofron taxi transport jashtë vendqëndrimit të taxive (neni 20 paragrafi 3),
4. Vepron në kundërshtim me nenin 20 paragrafi 5, neni 21 paragrafi 1 e 2,
5. Nuk kyq taximetrin me rastin e hyrjes së udhtarit në automjet (neni 23 parag.2),
6. Nuk kryen taxi-transportin nëpër rrugët të cilët i cakton udhëtari, përkatësisht nëpër rrugën më të shkurtër (neni 24),
7. Kompenzimin për transportin e kryer e arkëton në shumë më të madhe se shumata që e tregon taxi-metri (neni 37 parag. 1 e 3),
8. Vepron në kundërshtim me nenin 29 të kësaj Rregullore.

Për kundërvajtje nga paragrafi 1 pika 2, 3, 4 e 6 të këtij neni do të shqiptohet masa e mbrojtjes së ndalimit të kryerjes së veprimtarisë në kohëzgjatje prej 6 muajshë deri 1 vit.

Neni 35

Me gjobë prej 250 DM ose 125 € do të gjobitet për kundërvajtje ndërmarrja nëse nuk vepron në harmoni me dispozitat e nenit 8 paragrafi 5 të nenit 13 paragrafi 2, të nenit 14, të nenit 17 paragrafi 2 dhe të nenit 18.

Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij Vendimi do të gjobitet edhe personi përgjegjës në ndërmarrje me gjobë prej 50 DM ose 25 €

Neni 36

Për kundërvajtje nga nenet 22, 26 dhe 28 të kësaj Rregullore, inspektori komunal i komunikacionit ka autorizime të shqiptoj denimin (gjobën) mandator në shumën pre 100 DM ose 50 €

X. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 37

Drejtorati i Shërbimeve Publike ,Transport dhe Mbrojtje tëAmbientit, kompetent për trafik, në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, do të marrë atkvendim për:

1. Formën dhe përmbajtjen e lejes taxi (neni 8 paragrafi 6),
2. Formën dhe përmbajtjen e shenjës “TAXI”

Neni 38

Provimin nga njohuria e qytetit dhe dispozitave që rregullojnë taxi-transportin në qytetin e Prishtinës neni 4 paragrafi 1 e organizon DSHPTA në bashkpunim me Drejtoratin për Arsim dhe Kulturë në Komunën e Prishtinës.

Neni 39

Procedura sipas kërkesës për kryerjen e taxi-transportit që ka filluar, ndërkaq sipas të cilës nuk është marrë aktvendimi deri në hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, do të vazhdohet sipas dispozitave të kësaj Rregullore.

Neni 40

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

Nr. _____ Data _____

KRYETARI I KUVENDIT

Dr. Salih Gashi